

**UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**  
**PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE**



**UNIVERSITETI  
KADRI ZEKA  
UNIVERSITY**

# **PUNIM DIPLOME**

## **MASTER**

**Personazhi prind në veprat *Kukulla* të Kadaresë dhe  
*Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë* të Markesit - perceptimi i  
tyre nga nxënësit e klasës XII**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Merxhan Avdyli

Kandidatja:

Severxhane Aliu

Gjilan, shkurt 2024



**UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE**



**UNIVERSITETI  
KADRI ZEKA  
UNIVERSITY**

## **TEMË E MASTERIT**

**Personazhi prind në veprat *Kukulla* të Kadaresë dhe  
*Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë* të Markesit - perceptimi i  
tyre nga nxënësit e klasës XII**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Merxhan Avdyli

Kandidatja:

Severxhane Aliu

Gjilan, shkurt 2024

## PËRMBAJTJA

Lista e figurave .....	5
Abstrakti .....	6
Fjalët çelës .....	6
Abstract.....	7
Keyword .....	7
Deklaratë.....	8
Mirënjohje .....	10
Hyrje .....	11
1. Metodologjia.....	14
2. Pyetjet hulumtuese.....	15
3. Hipotezat.....	15
4. Shqyrtimi i literaturës .....	16
Kapitulli I.....	17
1.1. Ismail Kadare .....	17
2.1 Romani “Kukulla”.....	21
Kapitulli II .....	26
2.1. Gabriel Garsia Marquez .....	26
2.2. Romani “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” .....	30
Kapitulli III.....	35
Analiza e të dhënave.....	35
Përfundimi .....	48
Literatura .....	50
1. Libra .....	50
2. Nga interneti .....	50
Aneksi: Pyetësor për temë të masterit .....	53

## Lista e figurave

Figura 1. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e parë.....	36
Figura 2. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e dytë.....	37
Figura 3. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e tretë .....	38
Figura 4. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e dytë.....	39
Figura 5. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e pestë .....	40
Figura 6. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e gjashtë .....	41
Figura 7. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e shtatë .....	42
Figura 8. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e nëntë.....	44
Figura 9. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e dhjetë.....	45
Figura 10. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e njëmbëdhjetë.....	46

## Abstrakti

Qëllimi i këtij studimi ka qenë të analizojë, në rend të parë, veprat "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë" të Gabriel Garsia Marquez dhe "Kukulla" të Ismail Kadaresë, për t'u thelluar më hollësisht tek përfaqësimi i figurave prindërore në to, duke hulumtuar më pas ndikimin e këtyre veprave letrare te nxënësit e shkollave të mesme. Për këtë qëllim, në hulumtim është përdorur një pyetësor për të mbledhur të dhëna mbi ndikimet e këtyre veprave letrare në qëndrimet dhe perceptimet e nxënësve të shkollave të mesme ndaj figurave prindërore. Gjithashtu është përdorur edhe analizë cilësore, duke marrë për bazë kritikën që është shkruar për këta shkrimtarë të rangut botëror dhe për veprat që janë trajtim i kësaj teme.

Në pyetësor kanë marrë pjesë 86 nxënës të klasave XII të shkollës së mesme të mjekësisë "Elena Gjika" në Ferizaj. Nga përqindjet e përgjithshme të përgjigjeve të nxënësve, del se 62.8 % janë përgjigjur me 'Pajtohem' dhe 'pajtohem pjesërisht', ndërsa një numër tejet i vogël prej vetëm 3.22 % kanë zgjedhur opsionin 'Nuk pajtohem'. Pjesa tjetër që kanë zgjedhur opsionin 'Nuk jam i/e sigurt' përbëjnë pjesën e mbetur prej 33.97%. Prandaj, bazuar në këto përqindje, ka rezultuar që mbi 62 % e respondentëve janë pajtuar, dhe në anën tjetër, janë vetëm 3.2% që nuk janë pajtuar me pyetjet e shtruar.

Gjetjet e studimit mund të jenë të dobishme për pedagogët, mësimdhënësit, kujdestarët dhe prindërit në përzgjedhjen e literaturës për nxënësit e shkollave të mesme. Studimi mund të ofrojë gjithashtu njohuri për përdorimin e letërsisë si një mjet për përforcimin e botëkuptimit pozitiv tek fëmijët në raport me figurat e prindërve.

## Fjalët çelës

*Romani, letërsia, personazhi, marrëdhëniet prind-fëmijë, kukulla, koloneli, Kadare, Marquez*

## **Abstract**

The purpose of this study was to analyze, first and foremost, the literary works "No one Writes to the Colonel" by Gabriel Garcia Marquez and "The Doll" by Ismail Kadare, delving more deeply into the representation of parental figures in them, and thus researching the impact of these literary works on high school students. For this purpose, a questionnaire was used in the research to collect data on the effects of these literary works on the attitudes and perceptions of high school students towards parental figures. Qualitative analysis has also been used, based on the criticism written about these world-class writers and about the works analyzed in this study.

86 12th-grade students of the "Elena Gjika" Medical High School in Ferizaj participated in the questionnaire. From the overall percentages of students' responses, 62.8% answered with 'Agree' and 'Partially agree', while a very small number of only 3.22% chose the option 'I do not agree'. The rest who chose the option 'I'm not sure' make up the remaining 33.97%. Thus, based on these percentages, it resulted that over 62% of the respondents agreed, whereas, on the other hand, only 3.2% did not agree with the questions asked.

The findings of this study can be useful for educators, teachers, guardians and parents in the selection of literature for secondary school students. The study may also provide insight into the use of literature as a tool for reinforcing positive worldviews in children in relation to parental figures.

## **Keywords**

Novel, literature, character, parent-child relationship, The Doll, Colonel, Kadare, Marquez

## **Deklaratë**

Të gjitha fjalitë dhe idetë e përdorura në këtë temë diplome, të cilat janë marrë nga veprat e autorëve të ndryshëm, janë cituar në mënyrë të rregullt me anë të referencës së qartë të autorit, veprës dhe burimit. Jam e vetëdijshme që në rast të kundërt, përdorimi i teksteve apo ideve të huaja përbën plagjiaturë dhe do të konsiderohet arsye e mjaftueshme për mospranim të temës dhe mbrojtjes së saj në tërësi.

Emri dhe mbiemri: Severxhane Aliu

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: 6 shkurt 2024



“First your parents, they give you your life, then they try to give you their life.”

“Prindërit së pari të sjellin në jetë pastaj mundohen të ta japin jetën e tyre.”

- Charles Michael "Chuck" Palahniuk

## **Mirënjohje**

I jam thellësisht mirënjohëse mentorit dhe profesorit Prof. Asoc. Dr. Merxhan Avdyli për përkrahjen e pakursyer, jo vetëm rreth kësaj teme por, përgjatë gjithë periudhës së studimeve në Universitetin “Kadri Zeka”.

U jam gjithashtu mirënjohëse kolegëve të mi studentë për frymën e bashkëpunimit dhe veçanërisht nxënësve të shkollës së Mesme “Elena Gjika” të cilët, gjatë orëve mësimore, më kanë frymëzuar që ta zgjedh për hulumtim këtë temë si dhe për kontributin e tyre të çmueshëm që e kanë dhënë përmes pyetësorit.

Së fundi, dua të falënderoj familjen time, bashkëshortin dhe fëmijët e mi. Durimi dhe përkrahja morale e tyre gjatë studimeve, e posaçërisht gjatë punës në këtë temë, më ka mbajtur të motivuar gjatë gjithë këtij procesi.

## Hyrje

Prindërit janë heronjtë e parë, nga të cilët fëmijët marrin frymëzimin dhe njohin dashurinë e parë, por që, me kalimin e kohës, kjo marrëdhënie, shpesh ndodh të ndërlikohet. Marrëdhënia prind-fëmijë ka qenë dhe mbetet një temë e përhershme, sidomos në letërsi, e cila temë shpesh ka tejkaluar kulturat, periudhat kohore dhe stilet letrare. Kjo temë ka shërbyer si një dritare, përmes së cilës autorët kanë eksploruar gjendjen shpirtërore njerëzore, duke ofruar njohuri, në rend të parë, mbi ndjenjën e dashurisë dhe sakrificës por edhe finesat të tjera që përfshihen në këtë marrëdhënie. Në botën e letërsisë, pak aspekte të kësaj marrëdhënieje janë aq magjepsëse sa portretizimi i figurave prindërore, rolet dhe ndikimet e të cilëve mund të jenë po aq të larmishme sa edhe historitë nëpër të cilat kanë kaluar ata vetë.

Shembuj të trajtimit të kësaj teme i gjejmë te Shekspiri, p.sh. te “Hamleti”, “Mbreti Lir” etj., ku marrëdhënia prind-fëmijë trajtohet në mënyra të ndryshme.

Këto janë vetëm disa nga arsyt përse pikërisht këto dy vepra, të përfaqësuara nga autorë të klasit botëror, siç janë Markez dhe Kadare, janë përzgjedhur për këtë hulumtim. Të dy gjigantët letrarë, Ismail Kadare dhe Gabriel Garsia Markez, mjeshtërisht kanë ndërtuar rrëfime që thellohen në ndërlikimet e marrëdhënies prind-fëmijë. Në të dyja veprat ndeshemi me figura prindërore që nuk janë thjesht personazhe, por shërbejnë edhe për eksplorim më të thellë të temave që trajtojnë. Teksa lundrojmë nëpër veprat e tyre, bëhemi dëshmitarë të natyrave të shumanshme të prindërimit, ku dashuria mund të jetë po aq e ashpër sa është edukuese dhe ku sakrifica mund të marrë përmasa të paparashikueshme.

Të dy shkrimtarët, megjithëse kanë jetuar në realitete të ndryshme, sidomos kulturore dhe në largësi të dukshme gjeografike, si Ismail Kadare në Shqipëri ashtu edhe Gabriel Garsia Markez në Kolumbi, kanë ecur nëpër të kaluar të ndërlikuar politike e autoritare, kanë qenë dëshmitarë apo edhe protagonistë të pasojave politike, varfërisë së skajshme, përndjekjes, pasigurisë, etj. Në analizën që do t’iu bëhet të dyja veprave, ashtu sikur edhe në veprat e tjera të tyre, do vërehen nuanca të realiteteve diktatoriale, shtypja, përndjekja, ikja nga atdheu, etj. që kanë përjetuar autorët Markez dhe Kadare.

Rrugëtimi i këtij punimi do të zërthejë dhe krahasojë portretizimin e figurave të prindërve te "Kukulla" dhe "Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë". Nëpërmjet analizës së personazheve dhe marrëdhënieve prindër-fëmijë, do të zbulojmë shtresat e kompleksitetit

dhe të simbolizmit që janë të mishëruara në këto rrëfime. Nga figura enigmatike dhe imponuese e babait të Kadaresë deri te koloneli stoik dhe i qëndrueshëm i Markezit, do të tentojmë të eksplorojmë se si këto personazhe pasqyrojnë vlera më të gjera shoqërore dhe kulturore, duke shërbyer gjithashtu si protagonistë të narracionit artistik të autorëve.

Për t'i dhënë një drejtim të qartë rrugëtimit të këtij hulumtimi, janë dhënë edhe pyetjet hulumtuese

- *Sa i është dhënë rëndësi marrëdhënies prind-fëmijë nga autorët në veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë”?* dhe

- *Cili ka qenë ndikimi i veprave “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” tek nxënësit e Shkollës së Mesme?*

Këto pyetje pritet të shërbejnë si udhërrëfyes përgjatë gjithë studimit, të përcaktojnë qëllimin dhe kufijtë e studimit, duke ndihmuar kështu përqendrimin në objektivat kryesore. Për më tepër, për të kontribuar më tej në efektivitetin e projektimit të kërkimit dhe në pasurimin e gjetjeve të hulumtimit, janë dhënë hipotezat në vijim:

-*Marrëdhënies prind-fëmijë në veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” iu është dhënë rëndësi e konsiderueshme nga autorët dhe*

-*Veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” kanë pasur ndikim pozitiv të konsiderueshëm tek nxënësit e Shkollës së Mesme*

Përmes këtij punimi, jo vetëm që synohet të hidhet dritë mbi nuancat individuale të këtyre veprave, por gjithashtu synohet të tërhiqen paralele të caktuara mes tyre. Kësisoj, shpresojmë të hedhim pak dritë mbi të vërtetat universale të përvojës dhe rolit të prindërve në formësimin e jetës së fëmijëve të tyre, madje edhe brenda konteksteve kulturore që, në rastin konkret, janë të ndryshme por kanë edhe të përbashkëta.

Pyetëtori që do të përgatitet si pjesë e hulumtimit sasior, do të përfshijë pyetje që ndërliqhen kryesisht me përvojën e nxënësve të marrë nga veprat ‘Kukulla’ dhe ‘Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë’, duke tentuar të kuptojmë se si dhe sa kanë ndikuar ato në marrëdhënien e tyre me prindërit, a kanë arritur të vërejnë ndryshime tek marrëdhëniet e tyre me prindërit, t’i kuptojnë më mirë dhe t’i përqafojnë dallimet e gjeneratave, ta kuptojnë më mirë rolin e tyre si dhe ta shtojnë komunikimin apo respektin e ndërsjellë, etj.

Gjatë punës në këtë hulumtim, padyshim se nuk do të mungojë as shqyrtimi i literaturës së ndryshme të shkruar për autorët Markez dhe Kadare e posaçërisht për veprat përkatëse që janë pjesë e trajtimit në këtë temë.

Studimi synon të kontribuojë në literaturën ekzistuese që ka në përmbajtje përfaqësimin e figurave prindërore në letërsi dhe ndikimin e tyre tek lexuesit. Ai gjithashtu do të nxjerrë në pah rëndësinë e letërsisë në formësimin e qëndrimeve dhe perceptimeve të nxënësve ndaj figurës prindërore. Studimi do të përfundojë me sugjerime për kërkime të mëtejshme për mësimdhënien e letërsisë në shkollat e mesme.

Studimi do të ofrojë gjithashtu njohuri mbi kontekstet kulturore dhe shoqërore në të cilat autorët kanë shkruar romanet e tyre. Në fund të fundit, studimi synon të shtojë një kontribut, sado i vogël të jetë ai, në literaturën ekzistuese mbi marrëdhëniet prind-fëmijë në letërsi dhe shoqëri.

## 1. Metodologjia

Për të kryer këtë hulumtim është përdorur metoda cilësore dhe metoda sasore. Janë analizuar veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” dhe është nxjerrë një analizë e gjerë rreth trajtimit të personazheve prindër dhe në përgjithësi marrëdhënia prind-fëmijë. Janë analizuar burime të ndryshme kryesisht nga autorë të huaj por edhe vendorë. Janë marrë për bazë libra, shkrime në revista letrare dhe gazeta vendore e ndërkombëtare, siç janë *The Guardian*, sektori për librin, *Webster University*, *Cambridge University Press*, *NY Times*, *Koha Ditore*, *The University of North Carolina Press*, pastaj *ASHAK*, *Encyclopedia Britanica* dhe shumë të tjera.

Për ta plotësuar analizën sasore të kësaj teme, është krijuar një pyetësor me 11 pyetje për ndikimin e këtyre veprave në marrëdhëniet me prindërit e tyre. Dhjetë nga pyetjet kanë qenë të mbyllura dhe vetëm një pyetje e hapur. Pyetësi ka pasur si synim të marrë mendimet e nxënësve, të cilët, këto dy vepra i kanë pasur pjesë të plan programit mësimor në lëndën e Gjuhës shqipe.

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë 86 nxënës të klasave të 12-ta të shkollës së mesme të mjekësisë “Elena Gjika” në Ferizaj. Nga ta, 52 kanë qenë femra dhe 34 meshkuj. Pyetësi është realizuar gjatë periudhës kohore qershor - gusht 2023 përmes mënyrës online me Google Forms. Në këtë pyetësor është tentuar të merren përgjigje nga nxënësit rreth asaj se si e shohin ata figurën e prindit, se a kanë ndikuar pozitivisht për ta kuptuar më mirë rolin e prindit veprat që janë objekt i këtij studimi, se a kanë ndikuar këto vepra në përmirësimin e marrëdhënies së tyre me prindërit dhe nëse është vërejtur dallimi në marrëdhëniet prind-fëmijë në këto dy vepra, meqë veprat përfaqësojnë dy kultura nga popuj të ndryshëm dhe me një largësi të dukshme gjeografike.

Kufizime janë hasur nga të dyja metodologjitë e përdorura. Hulumtimi sasior ka nxjerrë në pah trajtimin jo të bollshëm të kësaj teme, në dukje periferike por shumë të rëndësishme nga kritika, meqë shumica e autorëve janë marrë me pjesën qendrore të këtyre veprave dhe jo me specifikat e marrëdhënieve prind-fëmijë dhe ndikimit të tyre.

Në anën tjetër, tek pyetësi numri i nxënësve që i janë përgjigjur pyetësorit ka dalë i mjaftueshëm por jo tërësisht i kënaqshëm, duke e pasur parasysh që sa më i madh numri i respondentëve aq më i pasur dhe më gjithëpërfshirës është rezultati.

## **2. Pyetjet hulumtuese**

Sa i është dhënë rëndësi marrëdhënies prind-fëmijë nga autorët në veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë”?

Cili ka qenë ndikimi i veprave “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” tek nxënësit e Shkollës së Mesme?

## **3. Hipotezat**

Marrëdhënies prind-fëmijë në romanet “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” iu është dhënë rëndësi e konsiderueshme nga autorët.

Veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë” kanë pasur ndikim pozitiv të konsiderueshëm tek nxënësit e Shkollës së Mesme.

#### 4. Shqyrtimi i literaturës

Qëllimi i shqyrtimit të literaturës së kësaj teme të diplomës është të ofrojë një përmbledhje gjithëpërfshirëse të literaturës ekzistuese dhe të hulumtimit të realizuar mbi këtë temë.

Rëndësia e hulumtimit dhe trajtimit të kësaj teme, në rend të parë, qëndron për faktin që marrëdhënia prind-fëmijë është e një rëndësie të veçantë. Përveç kësaj, ajo është universale dhe e gjithëkohshme. Kjo marrëdhënie, herë e dashur e herë e ndërlikuar, ka ekzistuar në çdo periudhë kohore dhe në çdo hapësirë. I ka qëndruar kohës dhe vazhdon të jetë e rëndësishme për çdo familje, në çdo cep të planetit.

Duke qenë e rëndësishme si temë dhe, me modernizimin e shoqërisë, gjithnjë e më e komplikuar dhe e diskutuar si marrëdhënie, hulumtimi synon të shërbejë dhe të japë një kontribut të vogël në vetëdijesimin e shoqërisë, përafrimin dhe njohjen e dallimeve që përfaqësojnë dy gjenerata të ndryshme.

Ajo që e bën edhe më interesant këtë hulumtim është fakti që kjo temë nuk është qendrore në veprat e analizuar "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë" dhe "Kukulla". Pra, analiza e trajtimit të personazheve prindër nga autorët e veprave në fjalë është kryer duke nxjerrë nuanca të stërholla nga pjesë të ndryshme të tyre, në të cilat, autorët Markez dhe Kadare trajtojnë këtë temë tërthorazi. Fakti që nuk është temë qendrore ka ndikuar edhe në vështirësinë për të gjetur materiale, libra, shkrime revistash që lidhen më specifikisht me të.

Kryesisht është nxjerrë analizë nga veprat në fjalë si dhe nga pyetëtori i bërë me nxënësit e shkollës së mesme të mjekësisë "Elena Gjika". Literatura tjetër e përdorur për këtë hulumtim, ka qenë kryesisht ajo e shkruar në gjuhën angleze në revista letrare dhe gazeta të njohura si *The Guardian*, sektori për librin, *Webster University*, *Cambridge University Press*, *NY Times*, *Koha Ditore*, *The University of North Carolina Press*, pastaj *ASHAK*, *Encyclopedia Britanica* dhe shumë të tjera. Madje edhe kritika e shkruar për Kadarenë dhe veprën "Kukulla" ka qenë më e bollshme në gjuhën angleze sesa në atë shqipe.



# Kapitulli I

## 1.1. Ismail Kadare

Ismail Kadare, si nga shqiptarët, ashtu edhe nga kritika e huaj, konsiderohet si shkrimtari më i madh shqiptar i të gjitha kohërave që promovon kulturën e historinë e shqiptarëve nëpërmjet artit të tij. Ai mbart mbi supet e tij çmime e mirënjohje kombëtare e ndërkombëtare të shumta. Ndër më të rëndësishmit është çmimi britanik *Man Booker International*. Në ndarjen e këtij çmimi, profesor John Carey, kryetari i jurisë, e quajti Kadarenë "...një shkrimtar universal në traditën e një rrëfimi që të çon prapa tek Homeri".

Kadaresë ende nuk i është ndarë çmimi Nobel për letërsi megjithëse është nominuar pesëmbëdhjetë herë dhe, nga shumë kritikë, gjithmonë është konsideruar si një nga kandidatët më seriozë për këtë çmim. Ai gjithashtu u shpall oficer i Legjionit Francez të Nderit, ndërsa më vonë, në vitin 2015 u nderua me çmimin The Jerusalem Prize, më 2019 me çmimin The Park Kyong-ni, dhe në vitin 2020 u nderua me çmimin Ndërkombëtar Neustadt për Letërsi (Enciclopedia Britannica).

Kadare u lind dhe u rrit në Shqipërinë komuniste, por iu dashtë të migronte në Francë, nga ku bota e njohu, u dashurua me shkrimet e tij dhe veprat e tij u shndërruan në trashëgimi të letërsisë botërore. U lind në Gjirokastrë, në janar të vitit 1936. Aty e mbaroi shkollimin fillor e të mesëm, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin Histori-Filologji të Tiranës. Studioi në Institutin Maksim Gorki të Letërsisë Botërore në Moskë. Vepra letrare e Ismail Kadaresë është shumë e gjerë dhe përfshin të gjitha gjinitë letrare, që nga krijimet për fëmijë e deri tek ato me poezi, tregime, novela, drama, poema, romane etj., (Demolli Arif, S.Xh, 2012).

Në moshën 13-vjeçare, Kadare zbuloi Makbethin, një ndër veprat e njohura të Shekspirit dhe kështu i lindi dashuria për letërsinë. Në librin e tij "Is that a fish in your ear?" (shqip: Është peshk ai që ke në vesh?), përkthyesi i njohur David Belos, përshkruan dashurinë e Kadaresë për 'Makbethin', i cili nëpër intervistat që kishte dhënë, sipas autorit, kur ishte pyetur se cili kishte qenë libri i tij i parë që e kishte shkruar, ai gjithmonë ishte përgjigjur: 'Makbethi'. Ky libër, sipas autorit, i ishte dhuruar Kadaresë nga xhaxhai i tij në një moshë të re, ndërsa Kadare ishte mishëruar aq shumë me dramën dhe

personazhet saqë disa herë i ishte bërë se e kishte parë Makbethin nëpër rrugët e Gjirokastrës.

Në këtë moshë shkroi tregimet e para, të cilat i botoi te revista ‘*Pionieri në Tiranë*’. Më 1954 botoi një përmbledhje poetike të quajtur “*Frymëzime djaloshare*”. Më pas shkroi shumë vepra, shumë prej të cilave u përkthyen afërsisht deri në 45 gjuhë të huaja (ASHAK). Ndër to u përkthye “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*”, vepra e parë e rëndësishme e Kadaresë dhe ‘*një pikë kthese në prozën moderne shqiptare. Në prozën e tij, Kadare e vështron të shkuarën jo vetëm si histori qëndrese heroike, por si histori mbijetese të identitetit shqiptar.*’ (ASHAK).

Kulmin letrar Kadare e ka arritur sidomos me romanet *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* (1964) dhe *Kronikë në gur* (1971). Edhe romanet e tjera të Kadaresë të periudhës së mëhershme të shkrimeve të tij, si: *Kështjella* (1970), *Pallati i ëndrrave* (1981), gjithashtu janë pritur mirë, si nga lexuesit, ashtu edhe nga studiuesit. (M. Avdyli, 2012)

Veprat e tjera të rëndësishme që u përkthyen përfshijnë veprat “*Kronikë në gur*”, “*Kush e sollti Doruntinën*”, “*Aksidenti*”, “*Kështjella*”, e shumë e shumë vepra të tjera, mes të cilave edhe romani “*Kukulla*”, i cili është temë trajtimi në këtë punim.

Shumë libra të tij nuk ishin lejuar të botoheshin, apo ishin ndaluar nga regjimi komunist i Enver Hoxhës menjëherë pas daljes në dritë. Disa nga to ishin “*Qyteti pa reklama*”, “*Përbindëshi*”, “*Pallati i ëndrrave*”, “*Nata me hënë*”, etj. Në vjeshtën e vitit 1990, i zhgënjyer nga përpjekjet e udhëheqjes komuniste për t’i zgjatur jetën regjimit, Ismail Kadare vendos të arratiset nga Shqipëria, shkon në Paris nga ku kërkon, nëpërmjet mediave perëndimore, vendosjen e demokracisë në Shqipëri. Në vitin 1996 u pranua në Akademinë e Shkencave Sociale dhe Politike në Francë, ku zëvendësoi filozofin Karl Popper (Konica.al).

Ai gjithmonë është vlerësuar lartë nga kritika botërore. "E kanë krahasuar me Gogolin, me Kafkën, me Oruellin. Por, ai i Kadaresë është zë origjinal, universal, e prapë me rrënjë të thella në tokën e vet." (Shusha Guppy, Independent on Sunday).

Duke bërë thirrje që Kadaresë t’i jepej më vlerësimi i vonuar që i takonte prej kohësh, revista letrare *Magazine Litteraire* do të shkruante: "Çdo vit, pothuaj gjatë një dhjetëvjeçari, Kadareja u ka dhënë lexuesve të vet nga një roman që i befason dhe i shtang ata, i prek në shpirt, u ngjall ndjenja e mendime të thella... Ka ardhur koha që Kadareja ta marrë çmimin që meriton... Jepjani Kadaresë çmimin Nobel!"

Bruce Bawer nga *Wall Street Journal* e quan Kadarenë "Një nga romancierët më të shquar të kohës sonë, në të gjithë botën dhe në të gjitha gjuhët."

Revista franceze *Figaro Littéraire*, duke e shprehur habinë që Kadaresë ende nuk i është dhënë çmimi i madh Nobel, shkruan: "E kemi thënë më parë dhe do ta themi prapë: kur do ta njohë Stokholmi kalibrin e jashtëzakonshëm të këtij shekulli?"

"Ai është krahasuar me poetin rus Yevgeny Yevtushenko për kundërshtimin e politikave të imponuara nga pushteti për letërsinë, po ashtu dhe me shkrimtarin kolumbian Gabriel García Márquez, kryesisht për shkak të interesit të tyre të përbashkët për grotesken dhe surrealen." (Enciklopedia Britannica)

"Një nga shkrimtarët e gjallë më të mëdhenj në botë." Simon Sebag Montefiore (penguin.co.uk)

"Në një botë të rregullt, Ismail Kadare tashmë do të kishte marrë çmimin Nobel për letërsi. Me çfarëdo gjykimi a përlllogaritje, ai është një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të gjallë evropianë..." Melanie McDonagh, *Evening Standard* (penguin.co.uk)

"Ismail Kadare, romancieri i frytshëm shqiptar, njihet më së shumti si një ironist që ka është krahasuar me George Orwell dhe Milan Kundera, duke shkruar përballë diktatorit të pamëshirshëm komunist Enver Hoxha, i cili sundoi Shqipërinë nga viti 1944 deri në 1985." Elisabeth Zerofsky, *The New York Times*, 17 nëntor 2020.

"Veçanërisht në prozë, qoftë në tregime, novela apo në romane, Kadare është sublim, suprem dhe i plotfuqishëm. Në shkrimin e prozës, qoftë në tregime, qoftë në novela, qoftë në romane, Kadare ka shpërthyer me një guxim të madh dhe si i tillë ka arritur të krijojë veçantinë e vet: atë kadareane, tashmë të afishuar dhe të pranuar botërisht." (M. Avdyli, 2012, f. 22)

"Proza e Kadaresë është proza e metaforës së madhe të absurdit ekzistencial, proza e parabolës, analogjisë dhe alegorizmit" (Prendi, 2015). Proza e tij trajton tema nga mitologjia shqiptare, botërore, zakonet e shqiptarëve, kompleksët e tabutë, sistemin totalitar, si dhe tema nga aktualiteti i vendlindjes së tij.

Të gjitha këto shkrime, të bëra nga kritika dhe revista letrare me renome në botë, janë lëvdata të jashtëzakonshme për Kadarenë, për stilin e tij të shkrimit, rrëfimet e jashtëzakonshme, përshkrimet e gjalla, personazhet e tij të jashtëzakonshëm të gdhendur

me imagjinatën e tij në mënyrë mjeshtërore dhe traditën e historinë shqiptare që është e mishëruar pothuajse në çdo shkrim të tij.

Ismail Kadare, gjatë periudhës së sundimit të regjimit komunist të Enver Hoxhës, kishte periudhën më të frytshme të krijimtarisë së tij, e cila njëkohësisht ishte edhe më e vështira. Ai jetonte dhe vepronte në mes artit dhe realitetit, me ç'rast i duhej të balanconte artin e tij me rezistencën dhe kundërshtitë që i kishte si artist ndaj pushtetit. Për këtë, edhe sot, perceptimi për Kadarenë është i ndarë në dysh. Një pjesë e lexuesve dhe kritikëve e quajnë hero për guximin që kishte në përdorimin e figuracionit në veprat e tij, duke e kundërshtuar kështu pushtetin, ndërsa pjesa tjetër e konsiderojnë si të përkëdhelurin e pushtetit, meqë Kadare nuk ishte burgosur, internuar apo likuiduar nga regjimi i atëhershëm, ashtu siç kishte ndodhur me shumë disidentë të tjerë.

“Kadare, kur rikujton jetën dhe veprën e tij në kohë të diktaturës, si dhe rezistencën e tij kundrejt saj, thekson se ai nuk e konsideron veten as hero, as disident, por një autor që ka shkruar letërsi normale në një ambient jonormal. Rezistenca më e madhe që mund të bëjë një autor nën diktaturë, është të krijojë letërsi normale.” (Hamiti et al., 2022)

Pushtetet diktatoriale, duke e kontrolluar jetën e njerëzve dhe duke ua mohuar atyre lirinë, mundohen t'i caktojnë normat e asaj se çka është e pranueshme e çka jo. Kjo rezulton në një uniformitet dhe skemë të caktuar të sjelljes, veprimit dhe krijimit artistik. Veprimi në rrethana të tilla është veçanërisht i vështirë dhe i pakapërdijshëm për artistët, e mbase edhe më e vështirë për shkrimtarët meqë iu mohohet shprehja e fjalës dhe mendimit të lirë. Për më tepër, diktaturat, pasi të kenë arritur shtypjen e fjalës së lirë dhe uniformitetin e mendimit, veprimit dhe të krijimit, zakonisht tentojnë që figurat e shquara në fushën e artit, por edhe më gjerë, t'i përdorin për qëllime të caktuara të propagandës.

“...diktatura e sheh letërsinë si mjet propagande edhe kërkon që shkrimi letrar të paraqesë jetën sipas ideve dhe veprimeve politike të pushtetit, duke ndikuar që autori të mos jetë me krijues i lirë, por shërbyes i ideologjisë. (Hamiti et al., 2022)

Siç dihet botërisht, ndrydhja apo shtypja e artistit nuk prodhon art, por e mbyl krijimtarinë, kufizon lirinë e shprehjes dhe rezulton në vepra që nuk pasqyrojnë në mënyrë autentike zërin ose vizionin e artistit. Kur artistët censurohen ose përballen me kërcënimin e ndëshkimit, autenticiteti dhe kreativiteti i punës së tyre rrezikohet.

“...letërsia dhe arti në përgjithësi e duan lirinë e individit, shprehësinë imagjinare, komunikimin kulturor, lidhjen me traditën dhe, para së gjithash, lirinë e autorit që ta shpreh botën e vet artistike ashtu siç e ndien dhe e dëshiron. Ismail Kadareja në këtë situatë rast ikjen nga realizmi socialist përmes shmangies nga qartësia dhe propaganda që kërkohet me ngulm në shkrimin e veprave me diskurs të dyfishtë, të figurshëm e alegorik për t’u shndërruar në autor që në kohë të antifigurës të krijojë vepra të figurshme letrare. (Hamiti et al., 2022)

## 2.1 Romani “Kukulla”

Kadare, në këtë roman që konsiderohet në masë të madhe autobiografik, paraqet në përgjithësi vështirësitë e nënës së tij dhe çështjet e tjera familjare, duke futur edhe elemente të nostalgjisë për atdheun e tij. ‘Në njohjen e parë, romani pjesërisht autobiografik i Ismail Kadaresë mund të lexohet si një kujtim elegant, i prekur nga nostalgjia për vendin e lindjes që tashmë është humbur prej kohësh.’ (John Brunside, Koha Ditore 2020).

Kadarenë e njohim si shkrimtar që merr për bazë dhe përfshinë elemente të historisë dhe kulturës shqiptare në veprat e tij. Kjo mund të vërehet edhe tek veprat e tjera, si “Kronikë në gur”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kush e solli Doruntinën”, etj. Nganjëherë, siç është rasti te ‘Kukulla’, ai i përdor këto elemente në prapavijë si elemente mbështetëse për të eksploruar tema më të mëdha dhe jo thjesht për të përshkruar drejtpërdrejt jetën ose përvojat e tij. Duke u ngacmuar nga nostalgjia për qytetin e lindjes, Gjirokastrën, ai paraqet shtëpinë e tij prej guri, e cila bart në vete histori, traditë por edhe ftohtësinë që e karakterizon gurin, duke e lidhur me marrëdhënien e ftohtë të dy grave më të afërta në familjen e tij ‘...shtëpia e paraardhësve të Kadaresë, një ndërtesë guri e ftohtë, por historike, e cila i ndan dy gratë që duhet ta bashkëndajnë atë.’ (John Brunside, Koha Ditore 2020).

Sipas Michele Levy, në artikullin e saj të shkruar në Revistën letrare *World Literature Today*, thotë se vepra e Kadaresë “Kukulla” ...”regon se si kufij të vendosur nga klasa tradicionale shqiptare dhe rregullat gjinore dhe qeveritë represive prekin familjen Kadare.” Sipas saj, Kukulla, si temë e këtij romani “thekson lidhjet e artistit me nënën e tij dhe vendin e tij. Por në një nivel më të thellë, ajo bëhet një kukull *matryoshka*

që përmban si figurë simbolike nënën, gjyshen, mëmëdheun dhe “nënën” e Kadaresë, të cilave ai përpiqet t’u gjejë zgjidhje, përpjekje kjo që nxit rritjen e tij artistike.”

Në faqet e para të romanit, autori rrëfen për sëmundjen e nënës së tij dhe kthimin e tij nga larg. Ai më pas vazhdon rrëfimin mbi fëmijërinë e tij dhe rëndësinë që kishte figura e nënës në atë periudhë për të dhe moshatarët e tij. Gjatë përshkrimit të nënës së tij, në perceptimin e tij prej fëmije, ai e konsideron atë si naive, e çuditshme dhe shpeshherë e tërhequr. Ai e përshkruan atë si një "kukull letre", e brishtë dhe e padepërtueshme, e ngrirë pas një maske të bardhë që ngjan me interpretuesit teatral *Kabuki*. Autori vazhdon me përshkrimin e lotëve të nënës dhe përpjekjet e tij që t’ia kuptonte pikëllimin. Por sipas tij për të zbrërthyer ishte e vështirë. Jeta e saj në shtëpinë e Kadarenjve duket disi monotone, gjë që autori mendon se është nga arsyet se pse ajo ndihet e pikëlluar. Një arsye tjetër tërthore autori mendon se është për shkak të martesës së saj të hershme në moshën 17-vjeçare. Një tjetër arsye e madhe duket të jetë martesë përmes marrëveshjes ndërmjet familjeve të tyre, siç ndodhte me shumicën e familjeve shqiptare, marrëveshje kjo të cilën nuk e kuptuan kurrë. Edhe vjehrra ‘kapedan’ - gjyshja e Ismailit, të cilën e përshkruan si grua të mençur dhe të zonja për punët e shtëpisë, kontribuonte në masë të madhe në palumturinë e kukullës në këtë familje.

Për më tepër, autori Kukullën e konsideronte si dembele prandaj raporti i saj me vjehrrën ishte paksa i vështirë, meqë kukulla u ikte punëve të shtëpisë duke ua lënë ato familjarëve të tjerë.

Për dallim nga familja e Kadaresë, familja e nënës, Dobatët, ishin familje e madhe, ndërsa Kadarenjtë duke qenë më të vjetër, shumica kishin vdekur. Kjo është një mungesë thekson autori: ‘Në shtëpinë tonë nuk vinin letra nga askush dhe kjo më dukej e natyrshme ngaqë dihej se të vdekurit s’dërgonin letra.’

Kukulla vinte nga një familje e pasur, për dallim nga familja e Kadarenjëve. Ajo do të detyrohej të mësohej të jetonte pa pamjen e violinave, të motrave dhe shërbëtorëve të saj. Martesa e kukullës fillon me përshkrimin e rrugëve dhe shtëpive që të qojnë deri tek shtëpia e Kadarenjëve. Shtëpia e Kadarenjëve, ku do të martohej kukulla, ishte disi e çuditshme, sepse dukej si burg i ngjuar nga e cila gjyshja e tij nuk dilte kurrë dhe kjo traditë, siç duket, do të përcillej edhe tek nëna e tij.

Gjatë viteve të pjekurisë, Kadare duket se fillon të ndjejë dhembshuri për vështirësitë e nënës dhe sado pak i kupton brengat e saj. I kupton padrejtësitë që i bëheshin

nga vjehrra dhe babai, të cilët figurativisht i quante gjykatës, meqë fëmijët e Kadarenjëve trashëgonin këtë ‘profesion’ nga prindërit e tyre. Babai i tij ishte djalë i vetëm i familjes, dhe sipas autorit ishte burrë tradicional, ngaqë fillimisht fajësonte të gruan para se të fajësonte nënën e tij për çdo mosmarrëveshje që ndodhte midis vjehrrës dhe gruas. E burgosura e shtëpisë, gjyshja ishte ajo e cila fillonte me konfliktet, e shqetësonte dhe i bënte padrejtësi kukullës. Kadare kishte shqetësim dhe merak kur e la nënën për të shkuar në Lice. Ai e vriste mendjen se si do t’i përballonte pyetjet, shqetësimet, intrigat e gjykatësve të familjes së tij.

Na shumë kritikë të kësaj vepre, besohet se Kadare përdor në mënyra të ndryshme simbolikën e nënës. Duke e shpjeguar frikën e nënës që biri tanimë i famshëm do ta mohonte, Entela Safeti Kalisi shkruan ”Kjo rritje e ndërprerë e saj, sjellë prej shkrimtarit, na kthen tek kuptimi i mëmëdheut të shkrimtarit, tek Shqipëria, pasi është pikërisht ajo lidhja organike që vjen tek shenjat; *Ishin dy botë që, me sa dukej, s’do të merreshin vesh kurrë. Në darkën e largët pariziane, duke më folur rusisht, për të mos e marrë vesh të tjerët, Voznjenski ishte përpjekur të më shpjegonte të pashpjegueshmen: moskuptimin me nënën e vet, Rusinë. Matma. Mamterr. Mater* kur ti i lindur prej saj, del në dritën e botës prej trupit të saj, nga errësira në dritë. Fjalët e gjuhës shqipe, mëmë-dhe, nënë-dhe, të cilat gjuhët e ndryshme i kanë në forma të ndryshme, për të krijuar lidhjen e njeriut me atdheun, na drejton kah leximi i marrëdhënies të shkrimtarit me Shqipërinë. Kukulla shndërrohet në atdheun e shkrimtarit. *Thirrja e saj; Mos më moho, ishte në të vërtetë: Mohomë, nëse të hyn në punë kjo...Apo ndoshta ishte e natyrshme në botën e saj...mes kukullave...kjo xheloz: art- nënë*” (Safeti Kasi, 2017)

Pas vdekjes së vjehrrës kukulla disi bëhet më e komunikueshme, bën pyetje më shumë. Por, kokëfortë mbetet prapë si në rastet kur kishte konflikt me gjyshen e Kadaresë. Pas botimit të librit të tij me poezi dhe tjetrit me prozë, Kadare bëhet më mendjemadh dhe këto veti duket se i ka trashëguar nga kukulla, e cila i bënte me mënyrën e saj, qofshin ato edhe të gabuara, thotë Kadare.

Ismaili thotë se kukulla i bënte shpesh pyetje me naivitet, të cilave iu përgjigjej me të qeshura ose i thoshte se janë broçkulla, ndërsa ajo ulte sytë poshtë dhe nuk fliste. Kukulla i bënte pyetje Kadaresë nëse ai do ta mohonte që e kishte nënë, pasi që ishte fituar famë pas botimit të librave.

Sipas profesoreshës universitare Eda Darhemi, Kukulla del të jetë një personazh shumë delikat po aq sa edhe shtjellimi i karakterit të saj nga shkrimtari. ”Kukulla është

një personazh shumë i ndërlikuar, dhe jo detyrimisht në kompleksitetin e vet si njeri, por në faktin që Kadare i vjen rrotull e s'ë rrok dot, apo i vjen rrotull e ka frikë mos e vrasë, e në këtë proces lodhës tërheq analiza të holla të tipareve të saj, si dhe asociime dhe gjetje letrare joshëse, por që më shumë kallëzojnë vlerat e tij si artist i fjalës dhe idesë, se sa shpjegojnë Kukullën.

Sipas autores, Kadare mbase e bën këtë për shkak se e ndien një lloj faji në mënyrën si e ka parë të ëmën si bir dhe do të racionalizojë e justifikojë veçantitë e Kukullës; ndoshta nga që Kukulla është tejet e vështirë të shndërrohet në një personazh heroinë të një romani. Dhe në këtë pikë autori duhet përgëzuar, se Kukulla, ashtu e paplotë, mua më ka mbetur në zemër si tip, me një keqardhje të pamatë. Kukulla, e përshkruar me mjeshtëri, është gjithsesi një personazh i hapur, në rastin më të mirë i papërfunduar, sido që e gjejmë që nga adoleshenca deri në ditën e vdekjes.

Në disa pjesë të librit, autori rrëfen jetën e tij studentore në Moskë, largimi nga Gjirokastra, shtëpia me qira nga babai dhe mungesa e ndjenjës së mërzisë nga largimi nga vendi i tij. Nga përshkrimi i tërthortë i autorit, duket se sistemi totalitar i asaj kohe në Shqipëri e bënte atë të mos e ndjente këtë mungesë.

Në të shumtën e situatave jetësore të tij dhe të kukullës, nënën e quan naive. Në një nga takimet e tij me një vajzë shkodrane, të cilën kukulla e kishte pëlqyer shumë dhe ia kishte propozuar për t'u fejuar, Ismaili e pati refuzuar pa e menduar. Edhe ky propozim i pamenduar ndodhte për shkak të naivitetit të kukullës.

Pastaj ndodh njohja me Helenen, për të cilën Kadare shpreson se do t'i pëlqente por kot, kukulla kishte mendjen tek shkodrانيا. Ajo ishte e inatosur pas refuzimit të ofertës që i bëri i biri. Kjo ishte traditë tipike e nënave shqiptare për përzgjedhjen e nuseve për djemtë të tyre, traditë që autori nuk e pëlqente si fenomen që ishte shumë i përhapur tek prindërit.

Dashuria me Helenen përshkruhet spontane. Familja e tij është e paksa e ftohur jo e afërt me njerëz të rinj. Në anën tjetër, kur autori flet për të atin e tij, flet për disa armiqësi (të menduara thellë) që ishin krijuar pasi autori kishte shkuar për studime në Moskë.

Mesa duket, largimi i tij nga Shqipëria, shpërngulja e tyre nga Gjirokastra për në Tiranë nga një shtëpi në një tjetër, që e quan burg për të atin dhe kukullën, ishin burim i armiqësisë me të. Kjo armiqësi, megjithatë nuk kishte asnjëherë konfrontime debatesh, por vetëm i mendonte ato në kokën e tij.



Sipas artikullit të The New York Times, shkruar nga Elisabeth Zerofsky, “Romani gjithashtu kthehet, pjesërisht, në një bildungsroman, ndërsa narratori përpiqet të tregojë se kishte diç në ndjeshmërinë e nënës së tij që e lindi me "dhuntinë e shkrimtarit" brenda tij. Ismaili shfaq bindjen e tij duke thënë "çdo gjë që e kishte dëmtuar Kukullën në jetë u bë e dobishme për mua në artin tim" dhe se nëna e tij kishte hequr dorë nga liria në jetën e saj "për të më dhënë të gjithë lirinë e mundshme si qenie njerëzore, në një botë ku liria ishte kaq e rrallë dhe e vështirë për t'u gjetur.”

Rrëfimi për vdekjen e babit jepet nga pjesët e parafundit të librit, pastaj ikja e tij nga Shqipëria bashkë me Helenen, shpallja e tij si tradhtar, bastisja e banesës së tij përbëjnë një copëz historie të dhimbshme nga jeta e autorit.

Në kapitullin e dymbëdhjetë kur shkrimtari rrëfen për vdekjen e kukullës, ky rrëfim është më i ndjerë dhe përjetim më i vështirë se ai i babait. Vdekjen e nënës autori e përjeton më rënd dhe për shkakun se kohëve të fundit jetonte larg saj në Paris. Kukulla në arkivolin e saj është bërë tamam si një kukull që i ngjante kukullave të teatrit.

Autori, në mbyllje të njërit prej kapitujve që përshkruan vdekjen e nënës së tij, shton: ‘Do të doja që, së paku në këto çaste, të të siguroja dhe një herë se moskuptimi midis nesh, jo vetëm s’më kishte penguar në asgjë, por kishte qenë ndoshta më i duhur se gjitha kuptimet. Sepse siç kisha dashur të ta shpjegoja kaq herë çështjen e dhuntisë, ajo mund të shfaqej pikërisht si e kundërta e vetvetes, një diçka e mangët në vend reprimi’. Siç është theksuar edhe nga kritika, gjegjësisht autorja amerikane Michele Levy, marrëdhënia e ndërlikuar e Kadaresë me nënën dhe problemet në familje vetëm sa i kishin shërbyer në ngritjen e tij artistike (Levy, 2020).

Pjesa e fundit e librit flet rreth restaurimit të shtëpisë së tij në Gjirokastrë, tek e cila kishte jetuar 17 vite. Dera me dalje të fshehtë e shtëpisë së tij, për të cilën ai thotë se nuk ishte në dijeni që ka qenë ndonjëherë, dhe hamendësohet kur e dëgjon nga arkitekti.

Libri përfundon me rrëfimin e befasisë për Helenen që i bëjnë disa këngëtarë nga Gjirokastra; këndojnë nusen e gabuar sepse kishte kaluar kohë, e që s’duhej ta kishin kënduar, thotë autori.

## Kapitulli II

### 2.1. Gabriel Garsia Marquez

Gabriel Garsia Marquez (Gabriel García Márquez), u lind më 6 mars 1927 në Aracataca të Kolumbisë dhe vdiq më 17 prill 2014 në Mexico City të Meksikës. Ishte romancier kolumbian dhe një nga shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit të 20-të, i cili u nderua me Çmimin Nobel për Letërsi në 1982, kryesisht për kryeveprën e tij *Cien años de soledad* (Njëqind vjet vetmi) e vitit 1967. Ai ishte i katërti shkrimtar latino-amerikan që u nderua dhe u vlerësua kaq shumë. Megjithatë ai është shkrimtari më i njohur latino-amerikan në histori. Përveç qasjes së tij mjeshtërore ndaj romanit, ai ishte një krijues i shkëlqyer i tregimeve të shkurtra dhe një gazetar i arrirë. Si në shkrimet e tij të shkurtra dhe ato të gjata, Gabriel Garsia Marquez arriti si rrallëkush të bëhej i kapshëm për lexuesin e zakonshëm, njëkohësisht duke kënaqur kritikët më kërkues e të sofistikuar (Echevarria, 2023).

Ai qe me i madhi prej gjashtëmbëdhjetë fëmijëve të familjes së varfër Marquez dhe u rrit nga gjyshja nga ana e nënës dhe nga tezet, deri sa u bë tetë vjeç. Gjyshja e shastiste me përralla magjike fantazmash, ndërsa gjyshi, dikur kolonel, i rrëfente ndodhi të vërteta luftërash civile nga historia e afërme e vendit. Siç duket, pikërisht të rrëfenjat reale dhe magjike të gjyshërve e kanë zanafillën romanet e mëdha të nipit, që pushtuan botën nën etiketën e realizmit magjik. Jo më kot Markezi do të shkruante: "Tërë shkrimet e mia burojnë nga përvoja e rrëfimeve të kohës kur jetoja me gjyshërit." (Marashi et al. 2003).

Si 13 vjeçar, ai shkoi në Bogota për të kryer shkollën e mesme. Më vonë filloi të studionte për drejtësi, por i braktisi studimet për të punuar si gazetar dhe shkrimtar. Gjatë viteve 1950 dhe 1960, ai punoi si korrespondent i huaj në Paris, Nju Jork dhe vende të tjera. Në fund të viteve 1960 ai u largua nga gazetaria për t'iu përkushtuar shkrimit të tij krijues me kohë të plotë. Përfundimisht García Márquez u vendos në Mexico City, ku jetoi deri në fund të jetës së tij. (webfaqja zyrtare e çmimit Nobel Nobelprize.org, 2023)

Gjatë studimeve të tij për drejtësi, në vend që të studiojë ligjet, Gabito, siç e quanin rrethi i ngushtë, studion shkrimtarët klasikë latinë e spanjollë, si edhe lexon Folknerin, Heminguejin, Xhojsin, Kafkën e Kamynë. Gjatë kohës sa punon si gazetar, ai shkruan edhe letërsi dhe është i interesuar të botojë veprat e tij të para. Sipas Marashi et al. (2001),

Markezit “...do t'i duhen pothuaj dhjetë vjet të tjerë që të mësojë zanatin dhe të botojë librin e vet të parë, Gjethurinat, më 1955, mbas refuzimit për tre vjet rresht nga botuesit, ndonjëri nga të cilët e këshilloi të merrej me çfarë të donte, veç jo me letërsi.”

Shpërthimi i tij në arenën ndërkombëtare ndodh pas botimit të romanit *Njëqind vjet vetmi*. Nga kritika, në përgjithësi konsiderohet që janë dy periudha të mëdha të krijimtarisë së Markez. Njëra para romanit *Njëqind vjet vetmi* dhe tjetra pas këtij romani.

“Me romanin *Njëqind vjet vetmi*, ai krijon universin e vet letrar të mirëfilltë, që ka si kuadër tropikun latino-amerikan, në të cilin veprojnë personazhe të çuditshme në situata të pazakonshme. Mbas këtij romani, ai vazhdon ta plotësojë dhe ta pasurojë veprën e vet, e cila në thelb thellon gjithnjë të njëjtën problematikë njerëzore, që silllet rreth kryetemave: diktaturë, dëshpërim, dashuri.” (Marashi et al. 2001).

Janë pikërisht këto tri tema që zënë vend të rëndësishëm edhe në veprën *Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë*. Diktatura madje, ka vend tejet të rëndësishëm përgjatë gjithë temës, duke u shprehur përmes orës policore, vrasjes së Agustinit për shkak të shpërndarjes së gazetave ilegale, etj. Edhe dëshpërimi në rastin e Kolonelit është një temë, prania e së cilës e ndjek si hija çdo ngjarje që ndodh aty. 15 vite pritje e dëshpërim për lajmin e pensionit që nuk përfundon as me përfundimin e vet veprës, ndërsa dashuria, si temë universale po ashtu është e shprehur përmes dhimbjes për djalin e vetëm Agustinin.

Këto tri tema duket të jenë karakteristikë qendrore e rrëfimeve të Markez, jo vetëm tek Koloneli por te shumica e veprave të tij. Për shembull tema e diktaturës është temë qendrore edhe në romanet *Ora ligë* dhe *Vjeshta e patriarkut*.

“Nxitje për këtë temë bëhet vetë realiteti kolumbian, ku diktaturat dhe juntat ushtarake mbajnë peng paqen dhe zhvillimin e vendit. *Vjeshta e patriarkut* vlerësohet, në pikëpamje të stilit dhe të strukturës, si vepra më e ndërlikuar e Markezit. Stili borak i romanit paraqet personazhe groteske që veprojnë në mjedise ireale.” (Hamiti et al, 2022)

Edhe dëshpërimi në një formë apo në një tjetër gjen vend pothuajse tek të gjitha veprat e Markezit. Për shembull, dallohet dëshpërimi nga diktatura, por edhe nga absurdi nga vetmia apo nga vdekja.

“*Kronikë e një vdekje të paparalajmëruar*” rrëfimi thuret në formën e një romani policor, kjo vepër përforcon idenë e fatalitetit dhe të dëshpërimit për një jetë njerëzore që mund të ishte shpëtuar, por që iu la vdekjes, edhe pse kjo vdekje ishte e paralajmëruar. (Hamiti et al, 2022)

Dashuria, përveç veprave të tjera, ku ka paraqitje të zakonshme, në mënyrë të veçantë shfaqet tek romani *Dashuri në kohë të kolerës*, Florentino Arisa pret gjysmëshekulli për ta realizuar dashurinë e madhe të jetës së tij me Fermina Dasën.

“Rrëfimi i Markezit na zhvendos në messhekullin XVIII latino-amerikan, në një mjedis plot ngjyra e paragjykime, ku merr një trajtë një ndër historitë e dashurisë më të fuqishme të kohëve. I shkruar nga një autor gjashtëdhjetë vjeçar, romani duket si ftesë për të gëzuar me çdo kusht jetën, përpara fundit dhe deri në fund. Te vepra *Dashuri e demonë të tjerë* ndjenja e dashurisë shprehet me një intensitet marramendës. (Hamiti et al, 2022)

Nën penën e Markezit, vendlindja kthehet në një vend mitik me emrin Makondo, ku zhvillohen ngjarjet e shumë romaneve të rëndësishëm, duke filluar nga *Gjethurinat*, duke vazhduar me *Ora e ligë* dhe *Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë*, duke shënuar një kulm me *Njëqind vjet vetmi*. (Hamiti et al, 2022)

“Një ditë, pas 18 muajsh pune të vazhdueshme, ai përfundoi një libër, të pestin me radhë. Aq i madh ishte ky libër sa gruas së tij Mercedes iu desh të linte si peng tharësen e flokëve dhe një ngrohës elektrik për të paguar postën për ta dërguar te botuesi. *Cien Años de Soledad* (Njëqind vjet vetmi) u botua në vitin 1967 (aq i madh ishte interesimi për botimin në spanjisht në atë kohë sa që nuk u botua as në anglisht deri tre vjet më vonë). Pablo Neruda, laureati i Nobelit në Amerikën e Jugut, e shpalli atë "ndoshta zbulimin më të madh në gjuhën spanjolle që nga Don Kishoti i Servantesit". (Iyer, 2014).

Njëqind vjet vetmi u shkrua në një vetmi të plotë, mbas një viti punë të ethshme, Markezi i dërgoi tre kapitujt e parë për lexim te shkrimtari Karlos Fuentes, i cili i shprehu publikisht mendimin e vet ‘Sapo lexova tetëdhjetë faqe nga një mjeshtër.’ Vetëm kur e kishte shkruar edhe faqen e fundit, i erdhi ndër mend titulli i shumëkërkuar: *Njëqind vjet vetmi*. Atëherë doli nga dhoma duke mbajtur në duar një deng me një mijë e treqind faqe, i sfilitur nga lodhja dhe i zverdhur nga nikotina, por krenar dhe i qeshur: kishte përfunduar librin për të cilin mbas pesëmbëdhjetë vjetësh do të nderohej me çmimin nobel. (Hamiti et al, 2022)

Megjithëse Markez, gjatë jetës së tij jetoi në disa vende të ndryshme, si Paris, Mexico City, Havana dhe Barcelonë, nga Kolumbia dhe nga e gjithë Amerika e Jugut ai konsiderohej një hero i tyre që e kishte bërë të njohur këtë pjesë të Amerikës, e cila në sytë e botës njihej më shumë për vrasje, krim dhe drogë. Megjithatë, Markez shumë shpejt

do të shndërrohej në një gjeni që nuk do t'i takonte më vetëm Kolumbisë apo Amerikës Latine, por të gjithë globit.

Ai është një nga interpretuesit kryesorë të të ashtuquajturit *realizëm magjik* në letërsi, një zhanër në të cilin narrativa vendoset në një vend dhe kohë reale, por ndërthurjet me elemente fantastike të mbinatyrshme janë pjesë e portretizimit. Romanet *Vjeshta e Patriarkut* e vitit 1975 dhe *Dashuria në kohërat e kolerës*, e vitit 1985 çimentuan pozicionin e tij si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të Amerikës Latine të të gjitha kohërave. (Echevarria, 2023)

Gabriel Garsia Marquez, i cili mori Çmimin Nobel për Letërsinë në vitin 1982, shkroi vepra artistike të rrënjosura në një peizazh mitik të Amerikës Latine të krijuar nga vet ai, por joshja i tij kishte përmasa universale. Librat e tij u përkthyen në dhjetëra gjuhë. Ai ishte në listën e zgjedhur të shkrimtarëve të cilët u përqafuan si nga kritikët ashtu edhe nga një audiencë masive si Dickens, Tolstoy dhe Hemingway (Kandell, 2014).

“Çdo vepër e tij e re pranohet nga kritikët dhe lexuesit në pritje si një ngjarje me rëndësi botërore”, u shprehën nga Akademia Suedeze gjatë dhënies së Çmimit Nobel.

Ndërsa vet Marquez, gjatë fjalimit të tij pas pranimit të Çmimit Nobel për letërsi më 8 dhjetor 1982, fillon fjalimin e tij me rrëfimet fantastike të eksploruesve në Amerikën Latine, duke theksuar përzierjen e realitetit dhe fantazisë në narrativat e tyre. Aty përmenden ngjarje dhe figura historike, duke vënë në dukje kontradiktat në historinë e Amerikës Latine, si kërkimi i Eldorados, brutaliteti i diktatorëve dhe pasojat tragjike të konflikteve politike. Ai më tej reflekton mbi sfidat me të cilat përballet Amerika Latine, duke theksuar luftën e rajonit për pavarësi dhe identitet.

Fjalimin e tij e përfundon duke bërë thirrje që njerëzimi të nis një fillim të ri, një fillim me më shumë liri, pa censurë e diktaturë, ku njerëzit do të ishin të lirë të mendonin e të jetonin ashtu si e ndjenin vetë e jo siç i diktonte dikush tjetër.

Duke e përmendur njërin nga heronjtë e tij, Faulkner ai vijon: “Në një ditë si kjo e sotmja, mjeshtri im William Faulkner pati thënë: "Unë refuzoj të pranoj fundin e njeriut". Do të isha i padenjë sikur të qëndroja në këtë vend që ishte i tij dhe nëse nuk do të isha plotësisht i vetëdijshëm se tragjedia kolosale që ai refuzoi të njihte tridhjetë e dy vjet më parë, tani, për herë të parë që nga fillimi i njerëzimit, nuk është asgjë më shumë sesa thjeshtë një mundësi shkencore.”

Ndërsa në përfundim të pjesës së fundit të këtij fjalimi ai pasqyron optimizmin dhe besimin e tij në fuqinë transformuese të tregimit dhe imagjinatës për të formuar një të ardhme më të mirë, gjegjësisht një utopi të jetës të karakterizuar nga liria, dashuria dhe lumturia. Ai parashikon një utopi të karakterizuar nga mungesa e imponimit të jashtëm mbi zgjedhjet e individëve, ku njerëzit nuk u nënshtrohen vendimeve të të tjerëve në lidhje me jetën dhe vdekjen e tyre. Ai dëshiron një botë ku dashuria është e vërtetë, lumturia është e arritshme dhe ku atyre që kanë qenë historikisht të marginalizuar ose të shtypur, që shkrimtari i përfshin përmes shprehjes "racat e dënuara me njëqind vjet vetmi", t'u jepet një mundësi e dytë, e pandikuar nga barrët e shkuara:

“Përballë këtij realiteti të mrekullueshëm që duhet të jetë dukur thjeshtë një utopi gjatë gjithë kohës njerëzore, ne, shpikësit e tregimeve, të cilët do të besojmë çdo gjë, ndjejmë se na takon e drejta të besojmë se nuk është ende vonë për t'u përfshirë në krijimin e utopisë së kundërt. Një utopi e re dhe gjithëpërfshirëse e jetës, ku askush nuk do të jetë në gjendje të vendosë për të tjerët se si do të vdesin, ku dashuria do të jetë e vërtetë dhe lumturia është e mundur dhe ku racat e dënuara me njëqind vjet vetmi do të kenë, më në fund dhe përgjithmonë, një mundësi e dytë në tokë.”

Pavarësisht vështirësive që përmend, autori e përfundon fjalimin me një qasje që artistët, e sidomos shkrimtarët e kanë ndaj jetës, një njohje të avantazhit të vazhdueshëm që ka jeta ndaj vdekjes, e mira ndaj të keqes dhe shpirti i qëndrueshëm i njerëzve përballë fatkeqësive e vështirësive në jetë.

## **2.2. Romani “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë”**

“*Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë*” mund të duket një vepër modeste, sepse linja e tregimit është e thjeshtë dhe joeksperimentale për nga teknika. Megjithatë, edhe sot, kjo vepër vazhdon të konsiderohet si një nga veprat më të mira të Gabriel Garcia Markezit (Mambroll, 2020).

Për më tepër, lloji i gjuhës së pranishme në vepër karakterizohet nga mbizotërimi i fjalorit të përditshëm dhe të thjeshtë, ku në qendër kryesisht është gjuha bisedore të cilën e përdorim në përditshmëri.

Ngjarja e librit fillon në muajin tetor, në muajin e përvjetorit të vdekjes së Agustinit, djalit të kolonelit. Pastaj vazhdon me përgatitjen e Kolonelit për të shkuar në një varrim të një muzikanti që sapo kishte vdekur nga shkaqe natyrore.

Ngjarja e kësaj vepre rrëfëhet në vetën e 3-të. Rrëfimtari nuk i përket veprës, domethënë nuk është personazh dhe i sheh ngjarjet nga jashtë, por i njeh ndjenjat dhe mendimin e personazheve.

Koloneli është personazhi kryesor i veprës. Ai është një burrë 75-vjeçar, i cili mezi priste të dilte në pension. Karakterizohet si një person me durim të hekurt dhe që nuk e humb shpresën kurrë. Kishte 15 vjet që e priste letrën e pensionimit. Personazhi i Kolonelit gjithashtu karakterizohet nga krenaria e pashoq, i cili nuk pranon të shfaq varfërinë e tij që të tjerët ta mëshirojnë. Ai gjithashtu shqetësohet për gruan e tij të sëmurë dhe ishte melankolik kur kujton vdekjen e djalit të tij që shpesh e kujton përmes gjelit, si i vetmi kujtim nga ai.

Varfëria ekstreme në të cilën jetonin koloneli dhe gruaja e tij shkonte deri në atë pikë sa të mos hanin e as të visheshin, pasi për të realizuar këto dy nevoja elementare duhej të shisnin gjërat e tyre ose thjesht të krijonin rroba të reja me të vjetrat. Megjithatë, Koloneli, edhe në situata të tilla mjerimi, gjente ushqim për gjelin.

Kjo vepër the rrëfimi i saj mund të thuhet se i përket botës së realitetit, pasi autori i ka shkruar ngjarjet sipas kontekstit të tyre historik dhe ka arritur të përshkruajë gjithë mjerimin në mënyrë kaq reale, për arsye se ka jetuar me të dhe i ka përjetuar shumë nga momentet që i përshkruan.

Përderisa në romanin e Kadaresë “Kukulla”, siç mund të kuptohet edhe nga vetë titulli, tema qendrore kryesisht sillet rreth prindit, më saktësisht nënës së Kadaresë, në romanin “*Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë*” të Markezit, marrëdhënia prind-fëmijë nuk është temë kryesore e kësaj vepre.

“Në veprën *Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë*, lexuesi zbulon përfundimisht, se përmban disa tema të ndërthurura. Përveç asaj në lidhje me djalin e kolonelit Agustinin, një tjetër trajton tensionet politike të qytetit dhe e treta përqendrohet te vetë Koloneli. Tema që merret me kolonelin, megjithatë, përfshin të dy të tjerat dhe dominon narrativen. (Mambroll, 2020).

*Koloneli...* ka në qendër Kolumbinë e viteve 1940-ta dhe 1950-ta, ku mbretëron ligji ushtarak dhe trajton në masë të madhe problemet politike e sociale të Amerikës

Latine të asaj kohe. Megjithatë, ndonëse në dukje të parë fare tërthore, një temë shumë e rëndësishme që shtrinë ndikimin e vet dhe e përshkon tregimin e shkrimtarit që nga fillimi i tij e deri në fund, është padyshim personazhi i Agustinit, djalit të Kolonelit. Qysh në fillim të veprës kuptohet se Agustini ishte vrarë për shkak të shpërndarjes së gazetave të ndaluara nga pushteti. Rasti i tij ndërlidhet mjaft shumë me boshtin e temës dhe ka ndikim të jashtëzakonshëm në rrjedhën e mëtejshme deri në përfundim. Është mjeshtërore mënyra se si shkrimtari e portretizon këtë marrëdhënie me djalin e tij të vetëm edhe pse Agustini vetë nuk paraqitet asnjëherë në vepër, por vetëm përmes rrëfimeve të prindërve dhe të shoqërisë për të. Madje një simbolikë e veçantë që e shfaq autori, i cili duket se zëvendëson praninë e munguar të Agustinit dhe, nga Koloneli sikur trajtohet si personifikimi i vetë të të birit, është gjeli, i vetmi kujtim i mbetur nga ai.

“Ndërsa gruaja e kolonelit është në zi të thellë për djalin e saj, koloneli e konsideron se ai jeton dhe është i fshehur. Ai e mban gjallë gjelin e djalit të tij për të njëjtën arsye që vazhdon të shpresojë për pensionin e tij - për të kërkuar një kuptim për të jetuar përtej faktit të thjeshtë të të jetuarit për të ngrënë. Gjatë gjithë kohës, Markez na bën të ndiejmë ritmin e jetës së tyre në ritmin e ngadaltë dhe të përgjumur të historisë”. (Corbet, 2001)

Përkushtimi i palëkundur i kolonelit për t'u kujdesur për gjelin, pavarësisht nga rrethanat e tyre të vështira, pasqyron sakrificat që prindërit janë të gatshëm të bëjnë për mirëqenien e fëmijëve të tyre, madje edhe kur ata fëmijë nuk janë më të pranishëm si në rastin konkret, vetëm për ta mbajtur gjallë kujtimin për ta. Vendosmëria e tij për të rrezikuar edhe mbijetesën dhe këmbëngulja përball vështirësive ekstreme, është një dëshmi e dashurisë së palëkundur prindërore.

Ndjenjat e kolonelit dhe gruas së tij për djalin e tyre të vdekur karakterizohen nga pikëllimi i thellë, malli dhe ndjenja e padrejtësisë. Koloneli shpesh mendon për Agustinin dhe është i përhumur nga kujtimi i vdekjes së djalit të tij. Gjatë gjithë novelës, ndjenjat e kolonelit për Agustinin u japin theks simbolikave të shpresës, qëndrueshmërisë dhe shpirtit njerëzor të fortë e stoik përball fatkeqësive. Përkushtimi i tij i palëkundur ndaj kujtimit të djalit të tij dhe refuzimi për ta shitur gjelin përkundër vështirësive ekstreme ekonomike, shërbejnë si simbole të aftësisë njerëzore për të mbajtur shpresën, dinjitetin e mbi të gjitha për ta mbajtur gjallë dashurinë dhe kujtimin edhe në rrethanat më të vështira.



Te romani “*Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë*”, Markez portretizon marrëdhënien prind-fëmijë si një marrëdhënie të karakterizuar nga humbja, dashuria, dhimbja dhe sakrifica. Mungesa e djalit dhe mungesa e komunikimit shërbejnë si një lloj simbolike e izolimit, vetmisë dhe dëshpërimit. Nëpërmjet kolonelit dhe gruas së tij, Markez eksploron ndikimin e pashmangshëm të mungesës së fëmijës tek prindërit dhe mënyrat në të cilat dashuria prindërore arrin të kapërcejë sfidat dhe rrethanat, në të cilat, ata sfidojnë edhe vet ekzistencën e tyre.

Koloneli kishte pesëmbëdhjetë vite që priste të pajisej me dokumentet e veteranit dhe kështu, për pesëmbëdhjetë vite qëndroi me shpresë se do merrte pensionin që i takonte si kolonel në luftën civile të Republikës së Kolumbisë, e zhvilluar në mes Partisë Konservative dhe Partisë Liberale.

Ai çdo të premte dilte tek dyqani i një siriani i quajtur Moises dhe shikonte letrat postare si dhe lexonte të rehat në gazetat e qytetit. Shkonte një e premte dhe e premtdja tjetër e gjente duke pritur, por vetëm për kolonelin postieri nuk kishte asnjë letër, asgjë. Kolonelit s’kishte kush t’i shkruante.

Gruaja e kolonelit ishte grua më e ngushtë se Koloneli dhe varfëria ekstreme i kishte ardhur në majë të hundës. Ajo vazhdimisht i bënte presion kolonelit që gjelin o ta shiste o ta therte. Ajo mendonte se do të vdisnin ashtu duke pritur kot dhe për të shtyrë edhe disa ditë, do të duhej të thernin gjelin apo t’ia shisnin shokëve të djalit të tij e ata të merreshin me garën. Koloneli thellë në shpirt ndjente pikëllim dhe plogështi. Gjeli ishte e vetmja gjë që kishin nga djali i tyre i vdekur. Koloneli tashmë po humbiste durimin dhe vazhdimisht shfrynte mllef ndaj luftës, ndaj sakrificës që kishte dhënë. Në anën tjetër, gruaja e tij i bënte trysni që të shisnin patjetër diçka se ndryshe do vdisnin urie. Trysnia e saj aq shumë u rrit e u teprua, saqë, në një moment kur ajo e mbërtheu për krahu kolonelin, e shkundi fort dhe e pyeti se çka do të hanin, ai u përgjigj: një m\*t!

Ditët ikin e siç duket, tetori sa vjen e bëhet më i vështirë për shkak të gjendjes ekonomike të tyre të dobët. Por që koloneli dhe gruaja e tij në roman përshkruhen përshkruhen si njerëz të cilët shpresat nuk i humbin aq lehtë. Ngaqë koloneli priste letrën e pensionit çdo të premte me shpresë se do t’i vinte, ndërsa gruaja e tij stilonte rroba të reja, nga rrobat që kishin pasur më parë dhe vazhdonin jetën me shpresë.

Një kohë të gjatë ata kishin jetuar ,me të hollat që kishte fituar Agustini, si rrobaqepës kur punonte sa ishte gjallë. Por prindërit si gjithmonë të ndërgjegjshëm dhe

mirënjohës për punën e tij, kujdeseshin t'i shpenzonin me kujdes meqë nuk kishin zgjidhje tjetër.

Vazhdonte shpresa dhe sakrifica e kryefamiljarit me përpjekjet e tij për marrjen e pensionit të veteranit të luftës përmes avokatit, i cili kërkonte të gjente dokumentet e humbura të pesëmbëdhjete viteve më parë. Të lodhur nga varfëria koloneli, gruaja bashkë me gjelin në vazhdimësi jetojnë çdo ditë me shpresë se një të premte do tu vinte pensioni i kolonelit, për një jetesë më të mirë se që kishin. Barra e kolonelit sa vinte e shtoej, sigurimi i ushqimit për gruan, vetën dhe gjelin bëhej i vështirë meqë s'kishin çfarë të hanin, duke e humbur krenarinë e fortë kishte, filloi të merrte hua në dyqane të ndryshme, me shpresë që të premten kur të vinte pensioni do ta shlyente borxhin.

Ndjenja e nevojës për të pritur, sikur gjithçka të ishte pezulluar ose bllokuar në një kornizë të ngrirë, përshkon të gjithë rrëfimin e veprës. Për pesëmbëdhjetë vjet, koloneli i varfër e i shkretë kishte pritur "postën", një copë letre për të cilën zëri i narratorit thekson se ka një rëndësi të madhe. Lexuesit mësojnë fillimisht për këtë pritje të gjatë kur koloneli largohet nga shtëpia e tij për të shkuar në portin e qytetit për të pritur postierin që sjell postën në qytet çdo të premte. Komploti që rrethon kolonelin sillet rreth pritjes për këtë pjesë të postës. Titulli i librit parashikon atë që koloneli konfirmon herën e parë që lexuesit e shohin të shkojë në port. Kur postieri njofton se nuk ka asgjë për kolonelin, koloneli përgjigjet: "Askush nuk më shkruan" (Mambrol, 2020).

Mundohej ta ushqente gjelin me disa kokrra fasule që kishin mbetur, për ta mbajtur gjelin për ndeshjet e radhës. Dhe kjo nuk mjaftonte, gruaja e tij insistonte që tua jepte gjelin shokëve të Agustinit, sepse mendonte që gjeli ishte shkaktar i vdekjes së birit të saj.

Nëna mendonte e mallkonte gjelat dhe thoshte se ia morën në qafë të birin.

Pas përpjekjesh për ta bindur kolonelin ta shiste gjelin, ai pranon, por me shpresë se gjeli do t'ia bënte njëqind pesos, për shkak të mbajtjes gjallë të familjes. Pazaret ndryshojnë dhe koloneli nuk e jep kollaj me çmim të lirë gjelin sepse për të vlente shumë. Prapë nuk humb shpresa për të, vazhdon e pret pensionin që kurrë nuk i erdhi.

Koloneli vazhdon mbijetesën duke ndarë kafshatën me gjelin për të ruajtur të vetmin kujtim që kishte për Agustinin. Tregimi mbyllet me kolonelin; i ndershëm, i pathyeshëm e plotë krenari të cilin vazhdon ta mbajë ajo fije e hollë shprese që nuk i ishte këputur kurrë.

## Kapitulli III

### Analiza e të dhënave

Për ta plotësuar analizën sasiore të kësaj teme, është krijuar pyetësori, përmes të cilit, është marrë mendimi i nxënësve, të cilët, këto dy vepra i kanë pasur pjesë të plan programit mësimor në lëndën e *Gjuhës shqipe*.


Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë 86 nxënës të klasave të 12-ta të shkollës së mesme të mjekësisë 'Elena Gjika' në Ferizaj. Nga ta, 52 kanë qenë femra dhe 34 meshkuj. Arsyeja e dallimit në numër, me ç'rast respondentët e gjinisë femërore shfaqen në numër më të madh, është për shkak se numri i nxënësve femra është dukshëm më i lartë se i atyre meshkuj.

Në këtë pyetësor është tentuar të merren përgjigje nga nxënësit rreth asaj se si e shohin figurën e prindit, se a kanë pasuar ndonjë ndikim për ta kuptuar më mirë rolin e prindit veprat e analizuara në këtë hulumtim, se a kanë ndikuar këto vepra në përmirësimin e marrëdhënies së tyre me prindërit, dhe nëse është vërejtur dallimi në marrëdhëniet prind-fëmijë, meqë veprat përfaqësojnë dy kultura nga popuj të ndryshëm, etj.

Më poshtë janë paraqitur rezultatet e pyetësorit në fjalë në formë tabelare dhe në formë shpjegimi.

**Pyetja 1.** Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar tek unë për të kuptuar më mirë rolin e prindërve të mi.

Nga pyetja numër një, 63.2 % e nxënësve janë pajtuar se e kanë kuptuar më mirë rolin e prindërve përmes këtyre veprave. Numri i atyre që janë pajtuar deri diku kanë qenë 28.9 %, një përqindje e vogël prej 5.3% janë përgjigjur që nuk janë të sigurt dhe krejt në fund, ata që nuk janë pajtuar përbëjnë një përqindje fare të vogël prej 2.6 %.



*Figura 1. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e parë*

**Pyetja 2.** Pas leximit të veprave 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' më është shtuar ndjenja e respektit ndaj prindërve.

Nga pyetja e dytë ata të cilët janë pajtuar se iu ishte shtuar ndjenja e respektit ndaj prindërve pas leximit të veprave në fjalë është 74.4 %. Ata të cilët janë pajtuar deri diku përbëjnë 20.5 % dhe 5.1 % ata të cilët nuk kanë qenë të sigurt. Opsionin 'nuk jam i/e sigurt' nuk e ka zgjedhur asnjë nxënës.





Figura 2. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e dytë

**Pyetja 3.** Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar tek unë për të kuptuar më mirë marrëdhënien prind-fëmijë.


Me pyetjen e tretë se a iu kishin ndihmuar këto vepra për ta kuptuar më mirë marrëdhënien prind-fëmijë janë pajtuar 59.9 %. Ata ose ato që janë pajtuar deri diku janë 33.3 %. Ata të cilët janë pajtuar deri diku përbëjnë 7.7 % të repondentëve, ndërsa pasionin 'nuk jam i/e sigurt' nuk e ka zgjedhur asnjë nxënës.



*Figura 3. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e tretë*

**Pyetja 4.** Edhe pse përfaqësojnë kultura të ndryshme, veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' njëjtë paraqesin dashurinë dhe dhimbjen që mbretëron në marrëdhënien prind-fëmijë.


Në pyetjen e katërt se a paraqitej në këto dy vepra njëjtë dashuria dhe dhimbja që mbizotëron në marrëdhënien prind-fëmijë edhe pse shkrimtarët përfaqësonin kultura të ndryshme, janë pajtuar 59 %, janë pajtuar deri diku 23.1 %, nuk kanë qenë të sigurt 15.4 % dhe nuk janë pajtuar një përqindje shumë e vogël prej 2,6 %.



*Figura 4. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e dytë*

**Pyetja 5.** Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë pasur rol edukativ tek unë.

Në pyetjen e pestë se a kishin pasur rol edukativ këto vepra tek nxënësit, janë pajtuar 59%, janë pajtuar deri diku 30.8% , nuk kanë qenë të sigurt 5.1% dhe nuk janë pajtuar është një përqindje e njëjtë prej 5.1%.




*Figura 5. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e pestë*



**Pyetja 6.** Pas leximit të veprave 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kam fituar bindjen se...


Në pyetjen e gjashtë nëse nga këto vepra kishin fituar bindjen se: dashuria e prindit ndaj fëmijës ishte më madhe sesa ajo e fëmijës ndaj prindit, si alternativë të parë e kanë zgjedhur 84.6%, alternativën e dytë se dashuria e prindit ndaj fëmijës është e njëjtte sikur ajo e fëmijës ndaj prindit, e kanë zgjedhur 15.4%, ndërsa alternativën e parafundit, që dashuria e prindit ndaj fëmijës është më e vogël sesa ajo e fëmijës ndaj prindit, nuk e ka zgjedhur asnjë respondent. As alternativën e fundit 'tjetër', e cila ka qenë e hapur për ndonjë koment, nuk e ka plotësuar asnjë respondent.



*Figura 6. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e gjashtë*

**Pyetja 7.** A mendoni se dallon trajtimi i personazheve prindërore nga autorët në këto vepra si rezultat i implikimit të kulturave që ata përfaqësojnë?

Në pyetje e shtatë, se a mendonin nxënësit se dallonte trajtimi i personazheve prindërore nga autorët në këto vepra si rezultat i implikimit të kulturave që ata përfaqësojnë, janë përgjigjur me ndoshta pak 76.9%, me Po janë përgjigjur 12.8%, ndërsa me Jo janë përgjigjur 10.3%.



*Figura 7. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e shtatë*

**Pyetja 8.** Nëse në pyetjen paraprake jeni përgjigjur me 'po', cili ka qenë dallimi që ju e keni vërejtur?


Në këtë pyetje, edhe pse ishte e hapur dhe respondentët kishin mundësi të shkruanin dallimet që kishin vërejtur, vetëm pesë nga ta janë përgjigjur. Përgjigja e parë nuk është shumë e qartë por duket se respondentja/ja ka vërejtur një dallim për shkak të kulturave të ndryshme të autorëve, respondentja e dytë ka vërejtur po ashtu dallime si rezultat i kulturave të ndryshme dhe e ka elaboruar me gjerësisht. Respondentët e tjerë duket se nuk kanë vërejtur ndonjë dallim.

Më poshtë janë paraqitur të plota dhe të paredaktuara përgjigjet e tyre.

1. Nga kultura te cilat ata janë rritur
2. Trajtimi i personazheve prindërore trajtohet ndryshe ngase kulturat e tyre janë ndryshe, vendet ku ata kanë jetuar kanë një largësi të madhe, koloneli jetote në Amerikë ndërsa nëna e autorit në veprën “Kukulla”, për të cilën bëhej fjalë, jetonte në Evropë, dhe kjo bën që të ketë dallim në trajtimet e personazheve prindërore. Poashtu unë mendoj që lidhja shpirtërore prind - fëmijë në veprën “Kukulla” të Ismail Kadaresë është më e madhe dhe më mirë e përshkruar se në veprën “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë”, ngase në veprën “Kukulla” autori përshkruan lidhjen e pazëvendësueshme nënë-bir, poashtu edhe Markez e përshkruan këtë veçse më ndryshe nga Kadare (disa tipare më pak të theksuara).
3. Sen skom vrejt
4. Gjate leximit
5. Skam verejtur asgje

**Pyetja 9.** Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar pozitivisht që të kem marrëdhënie më të afërt me prindërit.

Në pyetjen e nëntë, nëse këto dy vepra kishin ndikuar pozitivisht që nxënësit të kishin marrëdhënie më të afërt me prindërit, janë pajtuar 51.3%, janë pajtuar deri diku 33.3%, ndërsa nuk kanë qenë të sigurtë 10.3 dhe nuk janë pajtuar një përqindje e vogël prej 5.1%.



*Figura 8. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e nëntë*

**Pyetja 10.** Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar pozitivisht që të kem më shumë respekt ndaj prindërve.


Në pyetjen e dhjetë, nëse këto dy vepra kishin ndikuar që nxënësit të kishin më shumë respekt ndaj prindërve, janë pajtuar 60.5%, janë pajtuar deri diku 23.7%, nuk kanë qenë të sigurt 10.5% dhe nuk janë pajtuar 5.3%.



*Figura 9. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e dhjetë*

**Pyetja 11.** Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar që të kuptoj dallimin ndërmjet gjeneratave në marrëdhëniet prind-fëmijë.

Në pyetjen e njëmbëdhjetë, nëse këto dy vepra kishin ndikuar që nxënësit të kuptonin dallimet që ekzistojnë ndërmjet gjeneratave në marrëdhëniet prind-fëmijë, janë pajtuar 59%, janë pajtuar deri diku 23.1%, nuk kanë qenë të sigurt 12.8% dhe nuk janë pajtuar 5.1%.



*Figura 10. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen e njëmbëdhjetë*

Marrë për bazë të dhënat nga përqindjet e përgjithshme të përgjigjeve të nxënësve, del se 62.8 janë përgjigjur me ‘Pajtohem’ dhe ‘pajtohem pjesërisht’, ndërsa një numër tejet i vogël prej vetëm 3.22% kanë zgjedhur opsionin ‘Nuk pajtohem’. Pjesa tjetër që kanë zgjedhur opsionin ‘Nuk jam i/e sigurt’ përbëjnë pjesën e mbetur prej 33.97%. Prandaj, bazuar në përqindjet e sapo përmendura, me ç’rast mbi 62% e respondentëve janë pajtuar, dhe në anën tjetër, janë vetëm 3.2% që nuk janë pajtuar me pyetjet e shtruara, lirshëm mund të konkludojmë që hipotezat e shtruara në këtë temë:

*Marrëdhënies prind-fëmijë nga autorët në veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë”* iu është dhënë rëndësi e konsiderueshme dhe *Veprat “Kukulla” dhe “Kolonelit s’ka kush t’i shkruajë”* kanë pasur ndikim pozitiv të konsiderueshëm tek nxënësit e Shkollës së Mesme, janë vërtetuar.

## Përfundimi

Synimi parësor i këtij hulumtimi ishte kryerja e një analize fillestare të veprave "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë" të Gabriel Garsia Marquez dhe "Kukulla" të Ismail Kadaresë, me fokus të veçantë në eksplorimin e portretizimit të figurave prindërore. Për të kuptuar pyetjen kërkimore *Sa i është dhënë rëndësi marrëdhënies prind-fëmijë nga autorët në veprat "Kukulla" dhe "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë"?* është bërë një analizë cilësore duke u mbështetur në kritikën ekzistuese për këta autorë të njohur, në veçanti kritikën rreth veprave të tyre që janë trajtuar në këtë punim. Më pas, për të kuptuar pyetjen e dytë kërkimore *Cili ka qenë ndikimi i veprave "Kukulla" dhe "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë" tek nxënësit e Shkollës së Mesme?* është synuar të nxirren të dhëna mbi ndikimin e këtyre veprave letrare te nxënësit e shkollës së mesme. Për të arritur këtë, është përdorur një pyetësor me nxënësit e SHMM "Elena Gjika" me qëllim të mbledhjes së të dhënave mbi atë se si dhe sa këto vepra letrare kanë ndikuar në qëndrimet dhe perceptimet e nxënësve të shkollave të mesme ndaj figurave prindërore.

Të dhënat e përgjithshme zbuluan se 62.8 % e të anketuarve u pajtuan ose u pajtuan pjesërisht, ndërsa vetëm një numër i vogël prej 3.22 % zgjodhi opsionin që shpreh mospajtim me pyetjet e shtruar në pyetësor. Pjesa e mbetur prej 33,97 % kanë zgjedhur opsionin 'Nuk jam i sigurt'. Rrjedhimisht, këto përqindje sugjerojnë se një shumicë solide e nxënësve të anketuar janë pajtuar me pyetjet e parashtruara.

Njëra nga mangësitë dhe vështirësitë më të mëdha në këtë hulumtim ka qenë mungesa e kritikës mbi temën specifike të marrëdhënies prind-fëmijë në veprat "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë" dhe "Kukulla", meqë kjo temë nuk është qendrore në asnjërën nga këto vepra. Rrjedhimisht, edhe nga kritika kjo temë përmendet tërthorazi dhe kryesisht nuk trajtohet në mënyrë specifike. Kjo ka bërë që hollësitë mbi këndvështrimin e autorëve të ndryshëm mbi temën e marrëdhënies prind-fëmijë të nxirren me vështirësi.

Gjetjet e këtij hulumtimi mund të jenë të dobishme për edukatorët, mësuesit dhe prindërit në përzgjedhjen e literaturës për nxënësit e shkollave të mesme. Studimi do të kontribuojë në literaturën ekzistuese që ka në përmbajtje marrëdhëniet familjare, si dhe mund të ofrojë gjithashtu njohuri për përdorimin dhe rëndësinë e letërsisë si një mjet për përforcimin e botëkuptimit pozitiv të fëmijëve ndaj figurave të prindërve.



Studimi gjithashtu mund të ofrojë njohuri mbi kontekstet kulturore dhe shoqërore mbi të cilat autorët i kanë thur veprat e tyre.

Me shtimin e hulumtimeve të tjera në këtë temë apo tema të ngjashme, akterë të ndryshëm që merren me përpilimin e kurrikulave, botuesit e teksteve shkollore, apo përgjegjësit e arsimit në Kosovë, gjithashtu mund të krijojnë një pasqyrë më të qartë mbi atë se çfarë tema të përfshijnë kur përpilojnë tekste shkollore.

Në fund të fundit, ky studim mendohet se do të shtojë një kontribut të vogël në literaturën ekzistuese mbi marrëdhëniet prind-fëmijë në letërsi dhe shoqëri.

# Literatura

## 1. Libra

1. Kadare, Ismail, *Kukulla*, "Onufri", Tiranë, 2015.
2. Marquez, Gabriel G. *Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë*, Rilindja, Prishtinë, 1988.
3. Avdyli, Merxhan, *Përsosmëria shkrimore*, "Embata", Prishtinë, 2009
4. Avdyli, Merxhan, *Poezia kadareane*, "Embata", Prishtinë, 2015.
5. Boce, Elona, *Si të shkruajmë një punim kërkimor*, CDE, Tiranë, 2004.
6. Brada, Dr. Riza, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore*, Pejë, 2005.
7. Eco, Umberto, *Gjashtë udhëtime nëpër pyjet narrative*, Shkup, 1997.
8. Eco, Umberto, *Si shkruhet një punim diplome*, "Dituria", Tiranë, 2006.
9. Fraj, Nortrop, *Anatomia e kritikës*, Prishtinë, 1990.
10. Grup autorësh *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 2006.
11. Grup autorësh, *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006
12. Grup autorësh, *Letërsi në shkollë*, Tiranë, 2001.
13. Hamiti, Sabri - N. Krasniqi, A. Marashi, *Letërsia 12*, "Albas", Prishtinë, 2022).
14. Karamitri, Eleni, *Didaktikë e letërsisë*, Tiranë, 1999.
15. Marashi, Adrian - J. Doksani, L. Canaj. *Letërsia Botërore 4*, SHBLSH, Tiranë, 2001.
16. Ndoja, Leka, *Komentari i letërsisë*, Tiranë, 2011.
17. Velek, R., Voren, O., *Teoria e letërsisë*, Tiranë, 2012.
18. Zheji, Gjergj - Natasha Xhafka, *Fjalor enciklopedik letrar*, Tiranë, 2001.

## 2. Nga interneti

1. "Gabriel Garcia Marquez: A Study of the Short Fiction." *Studies in Short Fiction*, vol. 30, (1993), pp. 201+. Gale Literature Resource Center, [link.gale.com/apps/doc/A14081605/LitRC?u=googlescholar&sid=bookmark-LitRC&xid=91d62df7](http://link.gale.com/apps/doc/A14081605/LitRC?u=googlescholar&sid=bookmark-LitRC&xid=91d62df7).
2. Akademia e Shkencës dhe e Arteve, (tetor 2023) <https://ashak.org/anetaret/ismail-kadare/>

3. Shtëpia e librit, (2023), [www.shtepiaelibrit.com](http://www.shtepiaelibrit.com)  
<https://www.shtepiaelibrit.com/store/sq/romane/4036-kukulla-portreti-i-nenes-ismail-kadare-9789928186508.html>
4. Portali Konica, (20.09.2023), <https://konica.al/2019/01/kadare-si-u-arrestua-nga-regjimi-komunist-kur-ishte-vetem-12-vjec/>
5. Elisabeth Zerofsky, Nov. 17, 2020 The New York Times  
<https://www.nytimes.com/2020/11/17/books/review/ismail-kadare-doll.html> më 01.10.2023)
6. Gene H. Bell-Villada (2010), *García Márquez: The Man and His Work*, The University of North Carolina Press Philip Swanson (2010), Cambridge University Press, Cambridge: *The Cambridge Companion to Marquez* Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë - G. G. Marquez, Roberto González Echevarría (2023), Enciklopedia Britannica <https://www.britannica.com/biography/Gabriel-Garcia-Marquez>
7. <https://peizazhe.com/2017/09/05/kukulla-dhe-kurva-ne-kandarin-e-kadarese/> Safeti Kasi (2017), Portali shkollor, <https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/romani-kukulla-shqiperia-e-ismail-kadarese>
8. Gabriel García Márquez (Author), David Streitfeld (Editor) (2015): *Gabriel Garcia Marquez: The Last Interview: and Other Conversations*, Melville House
9. Faqja zyrtare e ndarjes së çmimit Nobel, (nëntor 2023),  
<https://www.nobelprize.org/prizes/literature/1982/marquez/biographical/>
10. Michele Levy, (2020) *Revista letrare World Literature Today*  
<https://www.worldliteraturetoday.org>,  
<https://www.worldliteraturetoday.org/2021/winter/doll-ismail-kadare>
11. Mato, Sulejman (2.12.2017) *"Kukulla" e Kadaresë, një roman që lexohet me një frymë*' MAPO, [eximtari.al/index.php/2017/12/07/kukulla-e-kadarese-nje-roman-qe-lexohet-me-nje-fryme/](http://eximtari.al/index.php/2017/12/07/kukulla-e-kadarese-nje-roman-qe-lexohet-me-nje-fryme/)
12. Pico Iyer, Time Magazine (2014) <https://time.com/67474/the-miraculous-life-of-gabriel-garcia-marquez/>
13. Jonathan Kandell, The New York Times (2014)  
<https://www.nytimes.com/2014/04/18/books/gabriel-garcia-marquez-literary-pioneer-dies-at-87.html>
14. John Burnside, The Guardian (9 Jan 2020)  
<https://www.theguardian.com/books/2020/jan/09/the-doll-by-ismail-kadare-review> ,

15. Nasrullah Mambrol, *Revista Literariness* (2020),  
<https://literariness.org/2020/09/26/analysis-of-marquezs-no-one-writes-to-the-colonel/>
16. René Prieto Bob Corbett, Webster University (2001),  
<http://faculty.webster.edu/corbetre/personal/reading/marquez-colonel.html> , (2011)  
'The body as political instrument: communication in *No One Writes to the Colonel*',  
Cambridge University Press
17. <https://thebookerprizes.com/the-booker-library/prize-years/international/2005>
18. David Bellos (2011) *'Is that a fish in your ear?'* Faber and Faber, New York,  
SHBA

## Aneks

### Pyetësor për temë të masterit

I/e nderuar nxënës/e,

ju lutem t'i ndani pak minuta nga koha e juaj për të më ndihmuar me këtë pyetësor me përgjigjet e juaja që kanë të bëjnë me veprat '*Kukulla*' (I. Kadare) dhe '*Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë*' (Gabriel G. Markez).

- Pyetësori është plotësisht anonim dhe nuk ka nevojë ta shënoni emrin tuaj.
- Rezultatet e tij do të përdoren vetëm për temën time të masterit.
- Pyetësori përmban 11 pyetje, kryesisht të mbyllura.
- Pyetësori parashihet se merr vetëm **rreth 2-5 min.** për t'u plotësuar.

Ju falënderoj shumë për kontributin tuaj!

Severxhane Aliu

**1. Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar tek unë për të kuptuar më mirë rolin e prindërve të mi.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem

**2. Pas leximit të veprave 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' më është shtuar ndjenja e respektit ndaj prindërve.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem

**3. Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar tek unë për të kuptuar më mirë marrëdhënien prind-fëmijë.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem

**4. Edhe pse përfaqësojnë kultura të ndryshme, veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' njëjtë paraqesin dashurinë dhe dhimbjen që mbretëron në marrëdhënien prind-fëmijë.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem

**5. Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë pasur rol edukativ tek unë.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem

**6. Pas leximit të veprave 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kam fituar bindjen se...**

- a) Dashuria e prindit ndaj fëmijës është MË E MADHE sesa ajo e fëmijës ndaj prindit
- b) Dashuria e prindit ndaj fëmijës është e NJËJTË sikur ajo e fëmijës ndaj prindit
- c) Dashuria e prindit ndaj fëmijës është e MË E VOGËL sesa ajo e fëmijës ndaj prindit
- d) Tjetër...

**7. A mendoni se dallon trajtimi i personazheve prindërore nga autorët në këto vepra si rezultat i implikimit të kulturave që ata përfaqësojnë?**

- a) Po
- b) Ndoshta pak
- c) Jo

**8. Nëse në pyetjen paraprake jeni përgjigjur me 'po', cili ka qenë dallimi që ju e keni vërejtur?**

---

---

---

**9. Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar pozitivisht që të kem marrëdhënie më të afërt me prindërit.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem

**10. Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar pozitivisht që të kem më shumë respekt ndaj prindërve.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem

**11. Veprat 'Kukulla' dhe 'Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë' kanë ndikuar që të kuptoj dallimin ndërmjet gjeneratave në marrëdhëniet prind-fëmijë.**

- a) Pajtohem
- b) Pajtohem deri diku
- c) Nuk jam i/e sigurt
- d) Nuk pajtohem